



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA
DEPARTAMENTI I GJUHËS ANGLEZE



PROGRAMI MËSIMOR I LËNDËS

Analizë Teksti e Gjuhës B (4)

Ngarkesa: 6 kredite, 60 seminare

Viti akademik, semestri kur zhvillohet: Viti II, sem. II

Lloji i lëndës: Lëndë e detyrueshme

Programi i studimit: Bachelor në Gjuhën Angleze

Kodi i etikës: Kodi i etikës i UT-së (nenet 4, 6, 7, 9)

PËRMBLEDHJE DHE REZULTATET E TË NXËNIT:

Objektivat e përgjithshëm lëndorë: Të konsolidojë dhe përmirësojë aftësitë e leximit në nivelin më të lartë akademik, në mënyrë që studentët të jenë në gjendje të lexojnë dhe kuptojnë tekste shkencore dhe revista ose gazeta nga fusha të ndryshme të jetës në MB, SH.B.A. apo vende të tjera. të pajisë studentët me aftësitë për të përdorur mënyra të ndryshme të komunikimit në fusha të ndryshme duke përdorur strategji të ndryshme të tilla si leximi midis rreshtave, parashikimi i kuptimit, bërja e parashikimeve, spekulimi dhe të qenit i vetëdijshëm për kuptimet e ndryshme që mund të ketë gjuha në kontekste të ndryshme së bashku me zhvillimin e suksesshëm të aftësive të ‘skimming’ dhe ‘scanning’. Të zhvillojë më tej aftësitë e dëgjimit, të cilat ngrihen në një nivel më të lartë dhe zbatimin e tyre për detyra specifike, sipas rastit, me materiale autentike. Të zhvillojë aftësitë e shkrimit në nivelin e përparuar duke u përqëndruar në zgjedhjen e informacionit specifik, lexuesit ose regjistrin më të përshtatshëm për këtë nivel. Të zhvillojë aftësitë e të folurit me një theks të veçantë në ndërveprimin shoqëror, gjuhën e transaksioneve, negociatave dhe hipotezave. Të pasurojë fjalorin dhe ta zbatojë atë gjatë aktiviteteve të ndryshme që ofron lënda. Nxjerrja e përfundimit që lidhet me parashikimin e kuptimit nga konteksti është veçanërisht e rëndësishme sepse tekstet e përdorura gjatë lëndës përmbajnë informacion të shprehur me fjalë të panjohura për studentët. Lënda synon të përmirësojë aftësitë e studentëve në fushën e stilit formal dhe atij joformal.

Rezultatet e të nxënit: Në fund të kursit studentët duhet të jenë në gjendje:

1. Të lexojnë, kuptojnë dhe përdorin tekste të zhanreve të ndryshëm nga fusha të ndryshme të botës akademike;
2. Të kuptojnë detaje, kuptime të ndryshme fjalësh, shprehje dhe fjali, kuptimin e nënkuptuar, organizimin dhe strukturën e teksteve;
3. Të komunikojnë lirshëm dhe në mënyrë efikase duke përdorur fjalor akademik për fusha të ndryshme;
4. Të krijojnë tekste të shkruara për tema të ndryshme, të cilat kanë ndikim në zhvillimin një vendi, duke përdorur fjalorin e duhur dhe struktura të sakta gramatikore;